



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:018841

Datë: 13.01.2025

Numri i dokumentit: 06700083

C.nr.2263/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE – Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Skender Shala, me praktikanten e kësaj gjykate Donika Parduzi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.Z nga Mitrovica, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Leutrim Ademi nga Mitrovica, kundër të paditurit K.M-DKSH, baza juridike: *Kompensim i pagës 13-të*, vlera e kontestit: 894.62 euro, jashtë seancës, me datë 13.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses A.Z nga Mitrovica, me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET e padituri K.M-DKSH, që te ia paguaj pagën e e 13-të, për vitet 2020 dhe 2021, me kamatë ligjore prej 8% në vit nga data e parashtrimit të kërkesës si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi A.Z nga M, përmes të autorizuarit të saj, ka paraqitur padi kundër të paditurit, me objekt kontesti: *Kompensim i pagës 13-të*, duke përshkruar gjendjen faktike si në vijim: Paditësi ka qene e punësuar tek e paditura dhe nga kjo marrëdhënie e punës ka realizuar dhe të ardhura. Me datën 12.06.2018 hynë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale, ku në bazë të kësaj marrëveshje parashtruesve të kësaj padie bazuar në nenin 17 par 2 i takon e drejta në 2 (Dy) paga në lartësinë e pagës bazë dhe atë për vitet 2020, 2021. Kete e bazon edhe ne bazuar edhe *Mendimin Juridik të miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023*. Përkundër

obligimit ligjor që në mënyrë zyrtare të bëhet zbatimi i kësaj kontrate lidhur me këtë padi, dhe atë brenda afatit një muor pas plotësimit të kushteve, deri me tani parashtruesit te padisë nuk janë kompensuar për këto paga të trembëdhjeta ashtu siç parashihet në nenin 17 par 2 te Kontratës Kolektive Sektoriale për Shëndetësi. Meqenëse Kontrata Kolektive Sektoriale nuk po zbatohet zyrtarisht ashtu siç është obligimi ligjor, paditësit i janë drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensim të pagave të 13-ta pikërisht në mbështetje të nenit 17 par 2 të Kontratës Kolektive dhe ndaj të njëjtave organi përgjegjës edhe me tutje nuk ka marrë asnjë veprim qoftë për refuzimin apo përmbushjen e këtyre kërkesave.

E paditura, përmes përgjigje në padi ka theksuar se: E kontestojmë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë lidhur me pagat e 13-ta, ngase me nenin 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale (Shëndetësisë), punëmarrësit ka mundur të i kompensohet paga e 13-të, për çdo vitë kalendarik në vlerë të pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, mirëpo në këtë rast punëdhënësi nuk ka pasur mundësi buxhetore që paditësve të ju bëjë kompensimin e pagës 13-të, Gjykata në mënyrë kronologjike ka analizuar situatën dhe duke e marrë të bazuar edhe *Mendimin Juridik të miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023*, në të cilin potencohet se kompensimi për punëtorët shëndetësor është kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, konkretisht nëse ka mjete buxhetore. I padituri që nga viti 2018 e deri më tani nuk ka pasur mundësi financiare që në asnjë vitë të realizojë këtë pagë. Situata kjo të cilën e elaboron Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të lartëcekur, në bazë të të cilit ky obligim mund të përmbushet vetëm nëse e paditura dëshmon se ka mundësi buxhetore për ta realizuar një detyrim të tillë. Përveq kësaj pretendon se kjo kerkese eshte edhe e parashkruar konform nenit 87 te ligjit te Punes. Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e PABAZUAR.

Gjykata lidhur me çështje ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, e ndërlidhje me nenin 399 par.1 të LPK-së që përcakton se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se pala paditëse ishte e punësuar tek e paditura dhe se gëzonin shpërblimin në emër të pagës bazë , mirëpo kontestues ishte baza e kërkesëpadisë, pra nëse palës paditëse i takon apo jo e drejta lidhur me kompensim të pagave të 13-ta të papaguara.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë, ka vendosur duke u bazuar në nenin 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 – të për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*.

Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit të pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provoj çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë. *(Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023)*.

Bazuar në një bindje të tillë, nuk është fare e nevojshme të procedohet tutje me caktimin e seancës gjyqësore për tu vërtetuar faktet e pretenduara nga pala paditëse, për faktin se ndërmarrja eventuale e këtij veprimi nuk do të ndryshonte pikëpamjet e Gjykatës në raport me themelësinë e kërkesëpadisë.

Nga interpretimi dhe arsyet si më lartë, gjykata ka vendosur që të refuzojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 *“Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të*

veta”, e lidhur me nenin 463.1 “Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”-të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL

C.nr.2263/2023, datë: 13.01.2025

Gj y q t a r i
Skender Shala

Udhëzim Juridik: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtijë aktgjykimi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.